

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-6608-5-2-1/C1475

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Ridvan Elezi B.L., Pellazgët 18A, Prizren, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit me numër identifikues: 622-24-6608-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit**

No.	Lot
1	Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **69,805.50 € (gjashtëdhjetë e nënt mijë e tetqind e pes euro e pesëdhjetë cent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Ridvan Elezi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-6608-5-2-1/C1475

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 2 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Çelë Lamaj Drejtor në DSHP Menaxheri i Kontratës është: Laura Suka IDA në DSHP
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shumën e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-6608-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Ridvan Elezi B.I., Pellazgët 18A, 20000, Prizren, Kosovë

E-mail: alfapz4@hotmail.com

Personi kontaktues: Ridvan Elezi

Telefoni: 049/135337

Faxi:

Numri fiskal: 811271642

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-6608-5-2-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit

3. Çmimi total i tenderit është:

69,805.50 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

PARAMASA

KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Furnizimin me material, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet - sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Paraprakisht punëkryesi për çdo pozicion duhet të kordinohet dhe të marrë aprovimin nga organi mbikëqyrës.


Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Totali
1	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI A				

1.1	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI A Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, përpunimi, montimi, vendosja dhe përfundimi i shtëpizave nga druri (dhe të gjitha elementeve përcjellëse). Shtëpizat e drurit Tipi A: (me destinim të ndryshëm), 8 copë me dimensione 200x200x230cm, të cilat do të jenë me konstruksion druri dhe elemente çeliku me mveshje nga druri i bungut. Shtëpizat do të kenë dy hapje, një hapje /derë 80x190cm nga ana e pasme për komunikim dhe furnizime si dhe një hapje/dritare 70x170cm përpara për shërbim dhe komunikim me klientët e cila hapet dhe përfundohet në dy pjesë (me profile çeliku 30x30x2mm), në atë të sipërme e cila do të kryejë edhe funksionin e strehës 40cm dhe e poshtme e cila do të kryejë funksionin e shankut 30cm ku do të shërbehen klientët. Muret do të jenë me shtresa si në vijim: dru bingu i lameluar 3cm + rrjetë mbrojtëse nga insektet + termoizolim 5cm + dru plywood 1.2cm. Mbulesa/Kulmi do të jetë dy ujor me pjerrtësi maksimale 15% streha e të cilit del anash nga perimetri i shtëpizës 30cm në të gjitha anët. Lartësia maksimale e kulmit do të arrijë në 240cm ndërsa ajo minimale 195cm. Konstruksioni/skeleti është nga druri dhe çeliku, me profile gjatësore dhe tërthore 100x100x5mm - L=200cm (kapja ankerimi i profileve gjatësore me ato tërthore të bëhet me Bulona me klip - M12, KL.8.8 n=15cm' për fiksim). Në sipërfaqe të vishet me dru bingu të lameluar me dimensione 2x20x200cm' ku montimi/palimi i tyre të bëhet 'goje me goje' (U+T) sikur laminati , gjeqjesisht në dukjet anësore do të jenë gjithsej 20 elemente/dërrasa me dimensione 2x20x180cm', në dukjen ballore do të jenë 6cope 2x20x180cm' + 4cope 2x20x170cm' + 8cope 2x20x5cm' , ndërsa në dukjen prapa do të jenë gjithsej 10 elemente / dërrasa me dimensione 2x20x100cm'. Në dukjen ballore dhe prapa do të jenë nga 3 elemente gjithsej 6 cope me prerje këndore në baze të kulmit. Kulmi poashtu do të jetë me dru të lameluar 20 copë 2x23x130cm'(në bazë) si dhe izolim dhe mveshje nga brenda. Struktura kryesore e shtëpizave të ketë ngjyrë druri bingu(të kafitë)të lyster me llak , ndërsa elementet/profilet	copë	8	3,500.00 €	28,000.00 €
-----	--	------	---	------------	-------------

1.2	Produkti duhet të jetë me origjinë vendore (punë me porosi). Shtëpizat e drurit duhet të jenë me elemente të parafabrikuar - e tërë montazhë (vendosja në lokacion të bëhet me vinç). Shtëpizat duhet të realizohen duke u bazuar në plane/detaje dhe me fotografinë referencë në përshkrim teknik dhe në pjesën grafike, (në këtë pozicion përfshihen kabllot, lidhjet, dhe të gjitha elementet përcjellëse si kapsat për kapje të druve brenda në strukturën e çelikut, bulonat e ndryshëm deri në funksionalizimin e plotë të elementit). Varesisht nga vendimi i shtëpizave specifikohet inventari. Shtëpiza tipi A: 3 / fast food, 2 / pije alkoolike, 1 / pije joalkoolike, 1 / suvenir, 1 / stil marketi. Punëkryesi duhet të parashohë realizimin e të gjitha elementeve sipas detajeve në projekt.				
-----	---	--	--	--	--




				TOTAL 1	28,000.00 €	✓
Nr.	SPECIRIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi/ njësi	Totali	
2	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI B					
2.1	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI B Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, përpunimi, montimi, vendosja dhe përfundimi i shtëpizave nga druri (dhe të gjitha elementeve përcjellëse). Shtëpizat e drurit Tipi B: (me destinim të ndryshëm), 7 copë me dimensione 200x250x230cm, të cilat do të jenë me konstruksion druri dhe elemente çeliku dhe mveshje nga druri i bungut. Shtëpizat do të kenë dy hapje, një hapje /derë 80x190cm nga ana e pasme për komunikim dhe furnizime si dhe një hapje/dritare 70x170cm përpara për shërbim dhe komunikim me klientët e cila hapet dhe përfundohet në dy pjesë (me profile çeliku 30x30x2mm), në atë të sipërme e cila do e kryejë edhe funksionin e strehës 40cm dhe e poshtme e cila do të kryejë funksionin e shankut 30cm ku do të shërbehen klientët. Muret do të jenë me shtresa si në vijim: dru bingu i lameluar 3cm + rrjetë mbrojtëse nga insektet + termoizolim 5cm + dru plywood 1.2cm. Mbulesa/Kulmi do të jetë dy ujqor me pjerrtësi maksimale 12% streha e të cilit del anash nga perimetri i shtëpizës 30cm në të gjitha anët. Lartësia maksimale e kulmit do të arrijë në 240cm ndërsa ajo minimale 195cm. Konstruksioni/skeleti është nga materiali i çelikut, me profile gjatësore dhe tërthore të çelikut 100x100x5mm - L=200cm (kapja ankerimi i profileve gjatësore me ato tërthore të bëhet me Bulona me klip - M12, KL.8.8 n=15cm' për fiksion). Në sipërfaqe të vishet me dru bingu të lameluar me dimensione 2x20x200cm' ku montimi/palimi i tyre te behet 'goje me goje' (U+T) sikur laminati, gjegjësisht në dukjet anësore do të jenë gjithsej 20 elemente/dërrasa me dimensione 2x20x180cm', në dukjen ballore do të jenë 11 copë 2x20x170cm' + 20 copë 2x20x20cm', ndërsa në dukjen prapa do të jenë 10 elemente / dërrasa me dimensione 2x20x140cm' + 10 copë 2x20x20cm'. Në dukjen ballore dhe prapa do të jenë nga 3 elemente gjithsej 6 copë me prerje këndore në bazë të kulmit. Kulmi poashtu do të jetë me dru te lameluar 26 copë 2x20x155cm'(në bazë) si dhe izolim dhe mveshje nga brenda. Struktura kryesore e shtëpizave të ketë ngjyrë druri bingu(të kaftë)të lyer me llak , ndërsa	copë	7	3,700.00 €	25,900.00 €	✓
2.2	Produkti duhet të jetë me origjinë vendore(punë me porosi). Shtëpizat e drurit duhet të jenë me elemente të parafabrikua - e tëra montazhë (vendosja në lokacion të bëhet me vinç). Shtëpizat duhet të realizohen duke u bazuar në plane/detaje dhe me fotografinë referencë në përshkrim teknik dhe në pjesën grafike, (në këtë pozicion përfshihen kabllot, lidhjet, dhe të gjitha elementet përcjellëse si kapsët për kapje të dritave brenda në strukturën e çelikut, bulonat e ndryshëm deri në funksionalizimin e plotë të elementit).Varësisht nga destinimi i shtëpizave specifikohet inventari. Shtëpiza tipi B: 3 / fast food, 2 / pije alkoolike, 1 / ëmbëlsira, 1 / ushqime tradicionale. Punëkryesi duhet të parashih realizimin e të gjitha elementeve sipas detajeve në projekt.					
				TOTAL 2	25,900.00 €	✓




Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali
3.0	TAVOLINAT				
3.1	TAVOLINAT Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja dhe përforcimi i mobilerisë. Tavolinat janë planifikuar të vendosen në mes të dy shtëpizave (13copë) me dimensione 180x70cm - h=110cm të cilat do të jenë me konstruktion çeliku dhe platformë nga druri i bungut. Punëkryesi duhet të parashih realizimin e të gjitha elementeve sipas detajeve në projekt. Shiko pjesën grafike të projektit 16.pdf	copë	13	300.00 €	3,900.00 €
				TOTAL 3	3,900.00 €
Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali
4.0	SHANKERICAT				
4.1	SHANKERICAT Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja dhe përforcimi i mobilerisë. Shankericat (40copë) Ø40cm me lartësi h=70cm (pa mbështetëse) të cilat do të jenë me konstruktion çeliku dhe platformë nga druri i bungut. Punëkryesi duhet të parashih realizimin e të gjitha elementeve sipas detajeve në projekt. Shiko pjesën grafike të projektit 16.pdf	copë	40	45.00 €	1,800.00 €
				TOTAL 4	1,800.00 €
Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali
5.0	TRUPAT NGROHËS				
5.1	NGROHËSJA ME GAZ Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja dhe përforcimi i mobilerisë. Bombolë gazi të cilat kanë lartësi deri h=220cm dhe diametër të bazës Ø46cm ndërsa diametri i pikës më të lartë arrin në Ø81cm. Këta trupa ngrohës funksionojnë me butona për ndezje/fikje dhe ngrije/ulje të temperaturës në 3 nivele, dhe janë planifikuar që të vendosen pranë tavolinave. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU. Punëkryesi duhet të bazohet në foto referencë sipas detajeve në projekt. Shiko pjesën grafike të projektit 17.pdf	copë	13	250.00 €	3,250.00 €
				TOTAL 5	3,250.00 €
Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali
6.0	KOSHA E MBETURINAVE				



6.1	KOSHA E MBETURINAVE Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja dhe përforcimi i mobilerisë. Vendosja e shportave të mbeturinave afër secilës shtëpie (15copë) me përmasa M/L - 55X85cm/75x90cm. Materiali plastike dhe metal. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU. Punëkryesi duhet të bazohet në foto referencë sipas detajeve në projekt. Shiko pjesën grafike të projektit 17.pdf	copë	15	150.00 €	2,250.00 €	✓
				TOTAL 6	2,250.00 €	✓
Nr.	SPECIFIKIMI IPUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali	
7.0	PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE					
7.1	Kabëll XOO (SNOB) 4X16mm² Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/shtrirja/lidhja e kablos për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	m'	220	6.00 €	1,320.00 €	✓
7.2	TABELA SEKONDARE 1 RENDSHE FID Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e tabelës për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	15	65.00 €	975.00 €	✓
7.3	SIGURESA 25 AMPER Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e siguresave për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	45	6.00 €	270.00 €	✓
7.4	SIGURESA 16 AMPER Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e siguresave për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	45	5.00 €	225.00 €	✓
7.5	SIGURESA 10 AMPER Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e siguresave për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	15	4.00 €	60.00 €	✓
7.6	PRIZ MONOFAZE - OG Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e siguresave për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	15	7.00 €	105.00 €	✓
7.7	PRIZ 3 FAZORE - OG Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/lidhja e siguresave për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	copë	15	8.00 €	120.00 €	✓



7.8	Kabëll NYM - 3X1.5mm² Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/shtrirja/lidhja e kablos për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	m'	90	1.20 €	108.00 €	✓
7.9	Kabëll NYM - 3X2.5mm² Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/shtrirja/lidhja e kablos për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	m'	75	1.30 €	97.50 €	✓
7.1.1	Kabëll NYM - 5X2.5mm² Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/shtrirja/lidhja e kablos për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	m'	75	5.00 €	375.00 €	✓
7.1.2	MATERIAL TJETËR Furnizimi, ngarkimi, transporti, shkarkimi, vendosja/shtrirja/lidhja e kablos për furnizimin e shtëpizave si dhe lidhja me ormanin ekzistues nga e cila do të bëhet furnizimi me energji elektrike. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU.	paushall			300.00 €	✓
				TOTAL 7	3,955.50 €	✓
Nr.	SPECIFIKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi / njësi	Totali	
8.0	PUNËT PËRFUNDIMTARE					
8.1	Deinstalimi, demontimi, ngarkimi, transporti dhe shkarkimi i gjithë elementeve të shtëpizave. I tërë materiali duhet të kthehet në deponë e komunës. Para se të kthehet materiali duhet të pakëtohet, ndërsa materiali nga konstruksioni i metalit/drurit të demolohet me kujdes të lidhen dhe të jenë të gatshme për ripërdorim. Preferohet që Shtëpizat të zhvendosen me vinç si teresi pa u demolu. Inventari të ruhet maksimalisht. Materiali i cili konsiderohet si material i shpenzuar duhet të specifikohet dhe të miratohet nga OM., dhe nuk mbetet në pronësi të komunës. Prodhuuesi duhet të japë garancion së paku 5 vite për shtëpizat (mure, dysheme, kulm).	herë	15.0	50.00 €	750.00 €	✓
				TOTAL 8	750.00 €	✓



REKAPITULIMI		
1	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI A	28,000.00 €
2	KONSTRUKTIMI I SHTËPIZAVE TË DRURIT - TIPI B	25,900.00 €
3	TAVOLINAT	3,900.00 €
4	SHANKERICAT	1,800.00 €
5	TRUPAT NGORHËS	3,250.00 €
6	KOSHA E MBETURINAVE	2,250.00 €
7	INSTALIMET ELEKTRIKE	3,955.50 €
8	PUNËT PËRFUNDIMTARE	750.00 €
TOTALI I SITUACIONIT TË PARË (I) DHE PËRFUNDIMTAR		69,805.50 €

Vërejtje: Për çdo Pozicion, Formsën të elementeve si ndriqese ashtu edhe konstruktive duhet të merret aprovimi nga Organit Mbikqyrës. Furnizimin me material, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Parapakisht punëkryesi për çdo pozicion duhet të kordinohet dhe të marrë aprovimin nga org.mbikqyrës.





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **129978**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Ridvan Elezi B.I. (N.P.N., Alfa - Ing)**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit.**

Nr. prokurimit: 622-24-6608-5-2-1 , Nr. brendshëm: 622-24-115-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **6,980.55€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **6,980.55€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 60 ditë kalendarike prej **28.08.2024** deri më **27.10.2024**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 27.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112: Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **129978**

Kontraktuesi	
Emri	Ridvan Elezi B.I. (N.P.N.,Alfa - Ing")
Përfaqësuar nga	Ridvan Elezi
Adresa	18, E Pellazgëve
Nr i Biznesit	811271642
Telefoni	044504458

Përfituesi	
Emri	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Adresa	PRIZREN

Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	

Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	6,980.55
Periudha Sigurimit	28.08.2024 - 27.10.2024
Primi	125.65
Tvsh	22.62
Primi Bruto	148.27
Data e lëshimit	27.08.2024 14:40

Aktiviteti Ekonomik:
Ndërtimi i shtëpizave për festat e funditvitit.

Lënda e Garancisë	
Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:	
1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.	
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.	
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).	
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.	
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)	

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Bajram Fazliu - 1940



Përfaqësuesi i të siguruarit
Ridvan Elezi